

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRONËS-AKP-së  
ŽALBENO VEÇE KOSOVSKE AGENCIJA ZA IMOVINU-KAI**

**GSK-KPA-A-045/15**

**Prishtinë**

8 Mars 2017

Në çështjen juridike të:

**B.P.**

**Pala ankuese**

Kundër

**A. K.**

I përfaqësuar nga:  
B. L., avokat nga Peja

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat: KPA32128, KPA93324, KPA93332, KPA93338, KPA93339 dhe KPA93356), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në 8 Mars 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e B. P., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-045/2015, GSK-KPA-A-046/2015 dhe GSK-KPA-A-51/2015, GSK-KPA-A-057/2015, GSK-KPA-A-058/2015 dhe GSK-KPA-A-063/2015 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-045/2015.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e B. P., të paraqitura kundër vendimit KPCC/D/A/228/2014 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA32128, KPA93324, KPA93332, KPA93338, KPA93339 dhe KPA93356), të datës 13 mars 2014.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 mars 2014, për sa i takon kërkesave të regjistruara me numrat KPA32128, KPA93324, KPA93332, KPA93338, KPA93339 dhe KPA93356.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 mars 2007, M. P. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur tri kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 260/1, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 03.00.00 ha (KPA32128), ngastrës kadastrale nr. 91/1, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 5.99.99 ha (KPA32129) dhe ngastrës kadastrale nr. 90/1, livadh me sipërfaqe prej 1.27.15 ha (KPA32127); të gjitha në vendin e quajtur "Piskote" në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: pronat e kërkuara).
2. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se posedimi ndaj pronave të kërkuara fillimisht ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur, ku kishte cekur datën 15 qershor 1999 si datën e humbjes, por më vonë ai e kishte autorizuar A. K. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) për të ndarë pronat e kërkuara dhe për të krijuar ngastra të reja kadastrale me qëllim të shitjes së tyre. Pala përgjegjëse në ankesë e kishte keqpërdorur autorizimin që i ishte dhënë atij dhe kishte keqpërdorur pronat e kërkuara.
3. Së bashku me kërkesën e tij paraqitësi i kërkesës i kishte siguruar AKP-së dokumentet vijuese:
  - Autorizimin me të cilin paraqitësi i kërkesës e kishte autorizuar Agjencinë për Patundshmëri "Kontakt" nga Peja, përkatësisht pronarin e saj A. K., për të ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim të matjes dhe ndarjes fizike të ngastrave kadastrale: 90/1 dhe 91/1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 07.27.14 ha, të regjistruara në Fletën Poseduese nr. 1013, Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës. Nënshkrimi i palës ankuese në Autorizim ishte legalizuar nga Gjykata Komunale e Kragujevcit më 9 tetor 2004 me numrin 463/2004;
  - Vendimin nr. 952-02-347/04, të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër i Komunës së Gjakovës, të datës 25 prill 2005, ku miratohet kërkesa e palës ankuese për ndarjen fizike të ngastrave kadastrale nr. 90/1 dhe 91/1 dhe krijimi i ngastrave të reja kadastrale.
  - Fletën poseduese nr. 93 të lëshuar më 20 qershor 2005 nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Gjakovës, ku ceket paraqitësi i kërkesës si bashkë-pronar me 4/5 pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr. 260/1.

- Transkriptin e Fletës Poseduese nr. 1013, të lëshuar nga Autoriteti Gjeodezik i Republikës së Serbisë, Komuna e Gjakova, ku ceket pronat e kërkuara në emër të palës ankuese (nuk ceket data e lëshimit).
  - Kopjen e kallëzimit penal të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës pranë Prokurorisë Komunale në Gjakovë më 19 dhjetor 2006 kundër palës përgjegjëse në ankesë për shkak të dyshimit të bazuar se ky i fundit ka kryer veprën penale të mashtrimit.
  - Padinë e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës pranë Gjykatës Komunale të Gjakovës më 15 janar 2007 kundër palës përgjegjëse në ankesë dhe I.P., me të cilën paraqitësi i kërkesës ka kërkuar nga gjykata të urdhëroj masat e përkohshme lidhur me pronat e kërkuara.
  - Deklaratën me shkrim të paraqitësit të kërkesës, të datës 23 mars 2007 ku thuhet se pala përgjegjëse në ankesë, në cilësinë e pronarit të Agjencisë për Patundshmëri “Kontakti” nga Peja, me ndihmën e znj. M.M, pronare e Agjencisë për Patundshmëri “Horizont” nga Kragujevci, e ka kontaktuar atë dhe i ka ofruar shërbimet e tij për ndërmjetësim dhe shitje të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ishte pajtuar me palën përgjegjëse në ankesë për të shitur pronat e kërkuara për çmimin prej 1000 Euro për ari. Shitja e parë në llogarinë e paraqitësi të kërkesës ishte bërë nga pala përgjegjëse në ankesë më 28 dhjetor 2004. Më vonë, paraqitësi i kërkesës e kishte tërhequr autorizimin që i kishte dhënë palës përgjegjëse në ankesë, por ky i fundit e kishte keqpërdorur atë dhe kishte vazhduar të shiste një pjesë të pronave. Gjithashtu, pala përgjegjëse në ankesë ka uzurpuar pjesën e mbetur të pronave dhe deri më tani pala ankuese nuk ka qenë në dijeni se çfarë kishte bërë pala përgjegjëse në ankesë me to.
  - Përgjigjen e palës ankuese (ndaj pretendimeve të palës përgjegjëse në ankesë) të paraqitur në AKP më 12 dhjetor 2013, që vërteton se pala përgjegjëse në ankesë dhe I. P. kishin lidhur Kontratën për Shitblerje për ngastrën kadastrale nr. 260/1. Kontrata ishte vërtetuar (nr. 2418/05) nga Gjykata Komunale e Mitrovicës më 18 shtator 2005.
  - Kopjen e Certifikatës së Vdekjes nr. 203-790/2014, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Arandelovac më 23 maj 2014 që dëshmon se M. P. kishte vdekur më 13 maj 2014. Certifikata ishte dorëzuar nga B. P., djali i M. P.
4. Nga të gjeturat e Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së (raportet e verifikimit të datave 7 dhe 13 shkurt 2014) mund të konstatohet se pronat e kërkuara (ngastra kadastrale 90/1 dhe ngastra kadastrale 91/1) ishin ndarë në ngastra të reja kadastrale, si dhe, ishin krijuar numra të rinj të kërkesave. Numri i ri i kërkesave dhe ngastrave kadastrale të kërkuara nga pala ankuese regjistrohen si më poshtë:

<b>Numri i ankesës dhe i Lëndës në AKP</b>	<b>Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar</b>
GSK-KPA-A-045/15 KPA32128	Ngastra nr. 260/1 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 03.00.00 ha
GSK-KPA-A-046/15 (kërkesa fillestare nr. KPA32129, kërkesa e re nr. KPA93324)	Ngastrat nr. 91/47, 91/48 dhe 91/49 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 00.30.00 ha
GSK-KPA-A-051/15 (kërkesa fillestare nr. KPA32127, kërkesa e re nr.	Ngastra nr. 91/40 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 00.09.62 ha

KPA93332)	
GSK-KPA-A-057/15 (kërkesa fillestare nr. KPA32127, kërkesa e re nr. KPA93338)	Ngastra nr. 91/59 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 00.20.00 ha
GSK-KPA-A-058/15 (kërkesa fillestare nr. KPA32127 kërkesa e re nr. KPA93339)	Ngastra nr. 91/62 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 00.20.00 ha
GSK-KPA-A-063/15 (kërkesa fillestare nr. KPA32127 kërkesa e re nr. KPA93356)	Ngastra nr. 91/51 që gjendet në vendin e quajtur “Piskote”, me sipërfaqe prej 00.50.00 ha

5. Identifikimi kërkesës për sa i përket ngastrës kadastrale nr. 260/1 ishte bërë më 18 nëntor 2013. Prona ishte gjetur e uzurpuar nga persona të panjohur.
6. Identifikimi i kërkesës për sa i përket ngastrave kadastrale me numrat 91/47, 91/48, 91/49, 91/40, 91/59, 91/62 dhe 91/51 ishte kryer më 12 nëntor 2014. Ato ishin gjetur të uzurpuara nga pala përgjegjëse në ankesë.
7. Pala përgjegjëse në ankesë ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronave të kërkuara dhe ka prezantuar dokumentet vijuese për të mbështetur pretendimet e tij
  - Kontratën e Shitblerjes nr. 164/03, të lidhur më 21 janar 2003 në Gjykatën Komunale të Gjakovës në mes të paraqitësit të kërkesës si shitës dhe R. K. si blerës. Sipas kontratës, paraqitësi i kërkesës e kishte shitur sipërfaqen prej 00.60.00 ha nga ngastra kadastrale nr. 260/1.
  - Autorizimin që i jep palës përgjegjëse në ankesë autoritetin për t’ia shitur pronën e paraqitësit të kërkesës, pra ngastrën kadastrale nr. 260/1, I. P. dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të bartur ngastrën e lartpërmendur në emër të blerësit. Nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës në Autorizim ishte legalizuar me numrin 3203/2005 nga Gjykata Komunale e Mitrovicës më 8 shtator 2005.
  - Deklaratën e paraqitësit të kërkesës ku ai thekson se ai ia ka shitur I. P. ngastrën kadastrale nr. 260/1, përmes personit të autorizuar (palës përgjegjëse në ankesë). Shitja ishte kryer me vullnetin e tij të lirë dhe ai kishte marrë çmimin e shitjes nga blerësi. Nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës ishte legalizuar me numrin nr. 3224/2005 nga Gjykata Komunale e Mitrovicës më 8 shtator 2005.
  - Kontratën shtesë të Shitblerjes, të lidhur më 11 janar 2006 në Gjykatën Komunale të Gjakovës (nr.65/06) në mes të paraqitësit të kërkesës (e përfaqësuar nga pala përgjegjëse në ankesë) në cilësinë e shitësit dhe I.P. në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate, pika 1 e Kontratës së Shitblerjes nr. 2418/05, e datës 12 shtator 2005 ishte korrigjuar. Paraqitësi i kërkesës dhe R. K. janë të regjistruar si bashkëpronarë të ngastrës kadastrale nr. 260/1, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 2.40.00 ha dhe ngastrës kadastrale nr. 260/5, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 00.60.00 ha. Paraqitësi i kërkesës ia kishte shitur I. P. pjesën e tij të pronës, duke mos e ndikuar pjesën ideale të bashkëpronarit tjetër, R. K.
  - Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 00093, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Gjakovës më 18 korrik 2013, ku ceket I. P. si bashkëpronar me

- 4/5 pjesë ideale të ngastrave kadastrale 260/1 dhe 260/5. Azhurnimi i të dhënave ishte bërë më 2 gusht 2011.
8. Raporti i verifikimit, i datës 7 shkurt 2014, tregon se ndarja e ngastrave kadastrale ishte bërë bazuar në vendimin Kadastral nr. 952-02-347/04, të datës 11 tetor 2004, i cili ishte lëshuar pas kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë në cilësinë e personit të autorizuar. Departamenti i Kadastrit kishte vërtetuar se pronat e kërkuara kanë pësuar shumë ndryshime që ndërliken me pronarët. Raportit të verifikimit i ishte bashkangjitur historiku kadastral nr. 952-03-8-2010, i datës 12 shkurt 2010, që shpjegonte ndryshimet për secilën ngastër kadastrale e cila ishte kërkuar. Gjendja aktuale është me sa vijon:
- Ngastra kadastrale nr. 260/1 i ishte shitur I. P. bazuar në Kontratën e Shitblerjes nr. 164/03, të lidhur më 21 janar 2003 në Gjykatën Komunale të Gjakovës;
  - Ngastra kadastrale nr. 91/47 i ishte shitur A. H. bazuar në Kontratën e Shitblerjes nr. 1929/05, të datës 4 gusht 2005;
  - Ngastra kadastrale nr. 91/40 i ishte shitur Q. H. bazuar në Kontratën e Shitblerjes nr. 2390/05, të datës 9 shtator 2005;
  - Ngastra kadastrale nr. 91/59 i ishte shitur C. D. bazuar në Kontratën e Shitblerjes nr. 2268/05, të datës 30 gusht 2005;
  - Ngastra kadastrale nr. 91/62 – pjesa ideale prej 4/5 ishte ri-shitur nga Xh. T. për T. S.dhe pjesa ideale prej 1/5 L. I., të dyja në bazë të Kontratës së Shitblerjes nr. 1394/06, të datës 31 maj 2006;
  - Ngastra kadastrale nr. 91/51 i ishte shitur S. K.;
9. Me vendimin e vet KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) kishte hedhur poshtë kërkesat. Në arsyetimin e vet, KKPK ka theksuar se paraqitësi i kërkesës nuk e kishte humbur posedimin mbi pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit gjatë viteve 1998-1999, por si rezultat i shitjes së vullnetshme pas konfliktit, prandaj, kërkesat binin jashtë juridiksionit të Komisionit.
10. Paraqitësi i kërkesës ka vdekur më 13 maj 2014 pas marrjes së vendimit të KKPK-së. Vendimi i ishte dorëzuar djalit të tij, B. P. më 25 gusht 2014. Më 22 shtator 2014, B. P. në cilësinë e palës ankuese kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 12 shkurt 2014. Ai ishte përgjigjur në ankesë më 6 mars 2015.

### **Pretendimet e palëve**

#### **Pala ankuese**

11. Pala ankuese kishte deklaruar se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore dhe shkelje të rëndë të së drejtës materiale dhe se ai mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
12. Pala ankuese thekson se pronat e kërkuara i përkisnin babait të tij (M.P.) dhe tani i përkasin atij, si trashëgimtar. Sipas tij, arsyetimi i vendimit të KKPK-së ku thuhet se babai i tij i ndjerë në mënyrë të vullnetshme ka tjetërsuar pronat e kërkuara te pala e tretë nuk qëndron, sepse tjetërsimi kishte ndodhur në mënyrë të jashtëligjshme, prandaj ishin iniciuar procedurat civile dhe penale dhe ato ende janë në vazhdim.

13. Në fund, pala ankuese kërkon nga Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës që të mos lejoj tjetërsim të mëtejme të pronave të kërkuara deri në përmbylljen e procedurave civile dhe penale, domethënë të mos i hedh poshtë kërkesat e tij.

### **Pala përgjegjëse në ankesë**

14. Përgjigja e palës përgjegjëse në ankesë kishte të bënte me vendimin e KKKPK-së nr. KPCC/D/A/227/2014, të datës 13 mars 2014. Pala përgjegjëse në ankesë mohon pretendimet e palës ankuese dhe pretendon se pala ankuese i kishte shitur pronat e kërkuara përmes tij si përfaqësues.
15. Pala përgjegjëse në ankesë e ka pohuar se lidhur me të njëjtën çështje pala ankuese ka iniciuar procedura civile ku kërkon kompensimin e vlerës së patundshmërisë. Procedura është në vazhdim në Gjykatën Themelore të Pejës. Gjithashtu, pala përgjegjëse në ankesë jep shpjegime detale në lidhje me fazat e procedurave gjyqësore. Ai kërkon nga Gjykata Supreme të refuzoj ankesat e palës ankuese si të pabazuara. Sipas palës përgjegjëse në ankesë, Gjykata Supreme duhet të shpall veten jo-kompetente mbi bazën e gjyq-vartësisë, sepse tashmë ekziston lënda civile C. nr. 196/12 në pritje të vendosjes në Gjykatën Themelore në Pejë, lidhur me pronat e kërkuara, dhe palët në procedurë janë të njëjta.
16. Për të mbështetur pretendimet e tij, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar dokumentet vijues pranë Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës:
- Autorizimin me të cilin pala ankuese e kishte autorizuar Agjencinë për Patundshmëri "Kontakt" nga Peja, përkatësisht pronarin e saj A. K., për të ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim të matjes dhe ndarjes fizike të ngastrave kadastrale: 90/1 dhe 91/1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 07.27.14 ha, të regjistruara në Fletën Poseduese nr. 1013, Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës. Nënshkrimi i palës ankuese nën Autorizim ishte legalizuar nga Komuna e Kragujevcit më 9 tetor 2004 (nr. 463/2004);
  - Vërtetimin e Kuvendit Komunal të Gjakovës të datës 22 prill 2005, ku jepet pëlqimi për ndarjen e pronave.
  - Vendimin nr. 952-02-347/04, të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër i Komunës së Gjakovës, të datës 25 prill 2005, ku miratohet kërkesa e palës ankuese për ndarjen fizike të ngastrave kadastrale 90/1 dhe 91/1 dhe krijimi i ngastrave të reja. Kërkesa i referohet gjithashtu pronave të kërkuara që përshkruhen në tabelën e prezantuar në paragrafin 4 të këtij aktgjykimi.
  - Padinë e paraqitur nga pala ankuese më 18 dhjetor 2006 në Gjykatën Komunale të Gjakovës kundër palës përgjegjëse në ankesë për pagesën e borxhit në shumën prej 155.00.00 Euro.

### **Arsyetimi ligjor**

### **Bashkimi i ankesave**

17. Sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të ligjit. Me këtë dispozitë ligjore parashihet bashkimi i i kërkesave kur ekzistojnë çështje të përbashkëta sikundër të bazës faktike ashtu edhe ligjore.
18. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile që janë të aplikueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me lëndën.
19. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të gjashtë rastet. Vetëm ngastrat, subjekt i të drejtës pronësore e cila pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe mbi dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.
20. Prandaj, ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-045/2015, GSK-KPA-A-046/2015 dhe GSK-KPA-A-51/2015, GSK-KPA-A-057/2015, GSK-KPA-A-058/2015 dhe GSK-KPA-A-063/2015 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-045/2015.

### **Juridiksioni**

21. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencën të zgjidh kërkesat që kanë të bëjnë me konfliktin e që përfshijnë rrethanat që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Pra, paraqitësi i ankesës jo vetëm që duhet vërtetoi pretendimet e tij pronësore mbi pronën e paluajtshme private por edhe duhet të dëshmoj se ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj këto të drejta për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
22. KKPK-ja vendosi se çështja nuk bie në kuadër të juridiksionit të vet pasi që humbja e posedimit nuk buron nga rrethanat e konfliktit të armatosur por është si rezultat i shitjes së vullnetshme pas konfliktit.
23. Gjykata Supreme konstaton se e drejta pronësore dhe posedimi mbi pronat e kërkuara nuk ishin humbur për shkak të konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998-1999 në Kosovë. Ky konstatim mbështetet në të dhënat e azhuruara kadastrale ku jepen emrat e pronarëve të rinj të ngastrave të kërkuara. Gjithashtu, babai i palës ankuese, me deklaratën e tij me shkrim, të datës 23 mars 2007, e vërteton se pala përgjegjëse në ankesë i kishte ofruar atij shërbimet e tij për ndërmjetësim dhe shitje të pronave të kërkuara. Babai i palës ankuese ishte pajtuar me palën përgjegjëse në ankesë për të shitur pronat e kërkuara për çmimin prej 1.000 Euro për çdo ari. Sipas deklaratës me shkrim, shitja e parë në llogarinë e babait të palës ankuese ishte kryer nga pala përgjegjëse në ankesë më 28 dhjetor 2004.

24. Nuk kontestohet nga asnjëra nga palët se babai i palës ankuese ishte bartësi i së drejtës pronësore ndaj pronave të kërkuara deri në vitin 2004, por humbja e të drejtave pronësore buron nga Kontrata e pretenduar e Shitblerjes. Gjithashtu, babai i palës ankuese saktësisht ka deklaruar se ai ka kërkuar nga AKP-ja të urdhëroj palën përgjegjëse në ankesë t'ia jep shitësit pjesën e mbetur të çmimit të shitjes.
25. Shitja e parë e pronës pretendohet të ketë ndodhur më 28 dhjetor 2004, në mes të babait të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë, domethënë pas një kohe relativisht të gjatë pas konfliktit dhe pastaj kishin pasuar shitjet e tjera (dokumentet e AKP-së në dosje i referohen viteve 2003, 2005 dhe 2006).
26. Pala ankuese thekson se shitja e pronave të kërkuara ishte bërë në mënyrë joligjore, dhe për këtë arsye ai kishte iniciuar procedurën civile për kompensim të vlerës të patundshmërisë.
27. Megjithatë, rrethana nëse kontratat janë juridikisht të vlefshme nuk është relevante në procedurën aktuale. Pretendimi për falsifikim nuk mund të ekzaminohet nga KKKPK-ja apo Gjykata Supreme në këtë rast. Kontratat e pretenduara, pavarësisht nëse ato janë të falsifikuara ose jo, duke marrë parasysh se ato i takojnë viteve 2003 dhe 2006, tregojnë se kontesti në fjalë në mes të palëve nuk është drejtpërdrejtë i lidhur me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/99 dhe as nuk rezulton nga ai. Çështja kontestuese në mes të palëve nëse kontratat ishin falsifikuar apo nënshkruar nën presion, nuk bie në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKKPK-së, pasi që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur.
28. Vendimi i kundërshtuar i KKKPK-së ishte lëshuar pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë si e drejta materiale ashtu edhe ajo procedurale ishin aplikuar në mënyrën e duhur.
29. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se KKKPK-ja duke hedhur poshtë kërkesat për shkak se bien jashtë juridiksionit të saj, ka lëshuar një vendim të drejtë. Rrjedhimisht, ankesat duhet të refuzohen si të pabazuara.
30. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
31. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtën e tij të pretenduar pranë gjykatës kompetente, nëse ai këtë e konsideron të domosdoshme.

### **Këshillë juridike**

32. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar



Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it